



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇËSHTJEVE DHE SHËRBIMEVE JURIDIKE

Nr. 957/ prot.

Tiranë, më 16.04.2022

URDHËR

Nr. 31, datë 16.04.2022

“PËR

MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT TË RISHIKUAR, NË ZBATIM TË OBJEKTIVAVE STRATEGJIKË TË PËRCAKTUAR NGA STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E DREJTËSISË 2021-2025, PËR PLANIN STRATEGJIK TË ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË 2020 -2022”

Në mbështetje të nenit 147/d të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 204, pika 1, shkronja “c”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar

KONSTATOVA SE:

Në kuadër të miratimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021–2025, planit të saj të veprimit, si dhe pasaportës së indikatorëve, me vendimin nr. 823, datë 24.12.2021, të Këshillit të Ministrave, janë përcaktuar katër qëllime kryesore për zbatimin e reformës në drejtësi. Secili qëllim i politikës, ka të përcaktuar objektiva specifike, masa konkrete në zbatim të objektivave, institucionet përgjegjëse, programin buxhetor dhe afatet përkatëse për realizimin e masave. Për çdo qëllim politik ka tregues kryesore të matjes së performancës, përmes së cilëve do të vlerësohet arritja ose përmbushja e objektivave të vendosura.

Me miratimin e Dokumentit Strategjik, grupi i punës me përbërje nga anëtarë të Drejtorisë së Analizës Ligjore dhe Hartimit të Akteve, Drejtorisë së Shërbimeve Juridike, Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe me kryesimin e Sekretarit të Përgjithshëm, kanë evidentuar të gjitha masat e përcaktuara në SND II, për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

Me qëllim harmonizimin dhe unifikimin e masave të parashikuara për ILD-në zbatim të SND II, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vlerësuar nevojën e rishikimit të masave në planin strategjik 2020-2022, duke përcaktuar objektivat dhe masat për të gjithë treguesit

sipas njërive përgjegjëse për ndjekjen dhe zbatimin e tyre bashkë me treguesit respektivë.
Për këto arsye:

URDHËROJ:

1. Miratimin e Planit të Veprimit të Rishikuar, në zbatim të objektivave strategjike të përcaktuar nga Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2021-2025, për Planin Strategjik të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 2020 – 2022, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse këtij urdhri.
2. Për vitin 2022, njësitë e ngarkuara për realizimin e masës apo aktivitetit, raportojnë sipas treguesve të rishikuar, në përputhje me afatet dhe procedurat e përcaktuara në urdhrin në fuqi për monitorimin e planit strategjik dhe planit të veprimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
3. Ngarkohen të gjitha njësitë e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me zbatimin e këtij urdhri.
4. Ngarkohet Drejtoria e Analizës Ligjore dhe Hartimit të Akteve për të reflektuar shtesat e miratuara me këtë urdhër në një tekst të vetëm integral që pasqyron variantin në fuqi planit të veprimit të planit strategjik të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, miratuar me urdhrin nr. 106, datë 01.11.2020 “Për miratimin e planit strategjik dhe planit të veprimit për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 2020-2022” dhe përcjelljen e variantit integral pas miratimit të këtij urdhri, Drejtorisë e Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse për publikim në faqen zyrtare.
5. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse për njoftimin e këtij urdhri dhe publikimin e planit të veprimit të rishikuar në faqen zyrtare të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Artur Metani

PLANI I VEPRIMIT I RISHIKUAR, NË ZBATIM TË OBJEKTIVAVE STRATEGJIKË TË PËRCAKTUAR NGA STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E DREJTËSISË 2021-2025, PËR PLANIN STRATEGJIK TË ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË 2020 -2022

Objektivi Strategjik 1: Fuqizimi dhe ushtrimi i veprimtarisë së ILD-së në mënyrë të pavarur, eficiente dhe profesional.									
<i>Objektivi Specifik 1.1 Zhvillimi i infrastrukturës së nevojshme për ushtrimin e funksioneve nga ana e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nëpërmjet sigurimit të hapësirave mjedisive, pajisjeve dhe kushteve të punës.</i>									
Masat / Aktivitetet e parashikuara	Struktura Përgjegjëse	Afati i realizimit	Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2020		Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2021		Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2022		Treguesi cilësor/sasior
			PBA	Donatorë	PBA	Donatorë	PBA	Donatorë	
Sigurimi i ambienteve (selia e ILD) të nevojshme për ushtrimin e funksioneve dhe zbatimin e objektivave ligjore	Inspektori i Lartë i Drejtësisë	Gusht 2020 ne vijim	1,184		8,124		190		1. Godinë 2. Numër të mjaftueshëm zyrash për 93 punonjës 3 Ambiente pune, sallë mbledhje
Rikonstruksioni i ambienteve të brendshme për pajisjen me ambiente pune për të gjithë numrin e punonjësve, sipas strukturës dhe organikës së miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me	Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse	Dhjetor 2021			20,000		60,000		Realizimi i projektit/ Përfundimi i zbatimit të projektit

vendimin nr. 28/2020.									
Pajisja e punonjësve me bazën logjistike të nevojshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj.	Sekretari i Përgjithshëm	Dhjetor 2020 Mars 2021 Mars 2022	6,911		32,000		2177		Pajisje informatike si PC, UPS, printer, skaner, fotokopje, si dhe pajisje e orendi zyre për punonjësit e rekrutuar
Planifikimi i bazës logjistike të nevojshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj, për numrin e përgjithshëm të punonjësve të miratuar sipas strukturës dhe organikës së miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me vendimin nr. 28/2020	Sekretari i Përgjithshëm	Dhjetor 2020 Mars 2021 Mars 2022	3,833		19,526		6,876		% e buxhetit të shpenzimeve operative e dedikuar për sigurimin e logjistikës së nevojshme për stafin e rekrutuar nëpërmjet blerjeve të materialeve dhe shërbimeve të domosdoshme për kryerjen e funksioneve
Sigurimi i ambienteve te posaçme me standardet teknike për pajisjet e zhvillimit te teknologjisë së	Sekretari i Përgjithshëm DESHM/ Sektori IT	Dhjetor 2022	0		0		0		Realizimi i projektit/ Përfundimi i zbatimit të projektit, me ngritjen e dhomës së serverit, i parashikuar ne projekt preventivin për

Informacionit (dhome e pavarur serveri), në përputhje me standardet Evropiane									rikonstruksionin e ambienteve te godines se ILD.
Zhvillimi i sistemit për lidhjen me rrjetin “Portën Qeveritare” që mundëson hyrjen në Sistemet IT të institucioneve të drejtësisë, KLGJ/KLP të nevojshme për punën e ILD.	Sekretari i Përgjithshëm DESHM / Sektori IT	Dhjetor 2022	0		0		0		Vendosja e paisjeve (firewall,rutera,instalim VPN etj) që mundëson një komunikim sa më të sigurt me sistemet e IT të Institucioneve të Sistemit të Drejtësisë
Masa 2.4.8 në funksion të realizimit të Objektivit Specifik 2.4, të SND II: Krijimi i infrastrukturës për të ngritur një njësi për pritjen e publikut pranë ILD-së.	DESHM	2022-2025							Raportim mbi ecurinë e procedurave për paraqitjen e kërkesave buxhetore planifikimin dhe zbatimin e e buxhetit krijimit të ambienteve të dedikuara për pritjen me publikun. Numri i raportimeve për kërkesat buxhetore.
<i>Objektivi Specifik 1.2 Sigurimi i autonomisë financiare dhe administrative të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.</i>									
Plotësimi i vendeve vakante në Institucion	Sekretari i Përgjithshëm dhe Njësia e Burimeve Njerëzore	2020-2021	2,179		1,597				Numri i punonjësve të plotësuar sipas strukturës
Hartimi i kërkesave buxhetore	Sekretar i përgjithshëm dhe Drejtoria e Ekonomike	2020/2021/2022	1,159		2,293		2,293		% e kërkesave të përfshira në PBA-në e miratuar

Objektivi Specifik 1.3 Përmirësimi i menaxhimit dhe komunikimit të brendshëm organizativ të administratës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë:

Përfundimi i përshkrimeve të punës, për të gjitha pozicionet.	DPÇSHJ, në bashkëpunim me të gjitha strukturat përbërëse të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	Dhjetor 2020	274						Numri i përshkrimeve të punës
Hartimi i rregullores për organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	DPÇSHJ, në bashkëpunim me Njësinë e Inspektorëve	Dhjetor 2020	6,122		862.94				Nxjerrja e urdhrimit për miratimin e rregullores
Njehsimi i dokumenteve administrative të nxjerra nga ILD.	DPÇSHJ	Shtator 2020	119		59.95		59.95		Nxjerrja e urdhrimit për njehsimin e dokumentave
Hartimi i rregullores së roleve dhe përdorimit të sistemit	DPÇSHJ	2020-2021	5,280		5,280		68.80		Nxjerrja e urdhrimit për miratimin e rregullores së përdoruesve të sistemit

Objektivi Specifik 1.4 Zhvillimi i sistemit të teknologjisë së informacionit për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Hartimi i projektit/ termave të referencës të sistemit të menaxhimit të çështjeve	Sekretari i Përgjithshëm në bashkëpunim me të gjitha strukturat dhe ekspertë të Huaj.	2021			938				Hartimi i projektit Zbatimi i projektit
Pajisja me software specifik për menaxhimin e dokumentacionit	Sekretari i Përgjithshëm në bashkëpunim me TIK, dhe AKSHI-n.	2021					2,000		Pilotimi i software Instalimi i software
Trajnime specifike për përdoruesit e sistemit		2021				0			Numri i trajnimeve të kryera

Objektivi Specifik 1.5 Rritja e njohurive dhe aftësive profesionale të inspektorëve dhe nëpunësve civilë, në mënyrë që secili prej tyre, në pozicionin përkatës të përmbushë në mënyrë eficiente detyrat e tij funksionale.

Bashkëpunimi me ASPA, Shkollën e Magjistraturës dhe ekspertë të huaj për ofrimin e trajnimeve	DPÇSHJ në bashkëpunim me Sektorin e burimeve njerëzore	Në vijimësi			0	0			Planifikimi dhe formalizimi i kërkesave për bashkëpunim
Ngritje e kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve specifike për pozicionet e punës	ASPA, Shkollën e Magjistraturës dhe ekspertë të huaj	2021				0			Numri i trajnimeve për çdo sektor
Konceptimi i termave të trajnimit në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës dhe ekspertë të huaj.	Shkolla e Magjistraturës dhe ekspertë të huaj	Në vijimësi			0	0			Hartimi i kurrikulave për çdo trajnim
Masa 1.3.3 në funksion të realizimit të Objektivit Specifik 1.3, të SND II: Ngritja dhe forcimi i kapaciteteve të inspektorëve të drejtësisë nëpërmjet trajnimeve specifike për pozicionet e punës.	Kabineti SP DESHM	2022-2025					5320		Bashkëpunimet kombëtare dhe ndërkombëtare (anëtarësimi në Rrjetin European të inspektimeve) për rritje kapacitetesh; Planifikim I fondeve buxhetore për ngritje kapacitetesh; Numri i takimeve të realizuara ose marrëveshjeve të arrira.

Objektivi Specifik 1.6: Ngritjen e një sistemi efektiv, transparent dhe objektiv të vlerësimit të performancës së inspektorëve.

Ngritja e Komitetit të emërimit dhe vlerësimit të performancës	ILD	Mars 2020	243			0			Numri i inspektorëve të vlerësuar
--	-----	-----------	-----	--	--	---	--	--	-----------------------------------

Hartimi i rregullave për kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jo magjistratë	ILD	Mars 2020	243		131.68				Hartimi i aktit për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jo magjistratë
Hartimi i rregullores për vlerësimin e Inspektorëve	ILD	Mars 2021	1,885		14.63				Miratimi i rregullores

Objektivi Strategjik 2: Zhvillimi i procesit të verifikimit, hetimit disiplinor dhe inspektimit në përputhje me parimet e procedimit disiplinor dhe standardet ndërkombëtare.

Objektivi Specifik 2.1: Krijimi i bazës për interpretimin dhe zbatimin e duhur të kuadrit të ri ligjor që ka të bëjë me veprimtarinë lidhur me përgjegjësinë disiplinore të magjistratëve.

Masat / Aktivitetet e parashikuara	Struktura Përgjegjëse	Afati	Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2020		Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2021		Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2022		Treguesi cilësor/sasior
			PBA	Donatorë	PBA	Donatorë	PBA	Donatorë	
Hartimi i manualit të hetimit disiplinor ku përfshihet edhe komentari i ligjeve që rregullojnë veprimtarinë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	DPÇSHJ, në bashkëpunim me inspektorët, ndihmësinsektorët, nën asistencën e ekspertëve të misionit EURALIUS V	2021	26		492.71				Hartimi i aktit për miratimin e manualit
<i>Objektivi Specifik 2.2: Standardizimi/unifikimi i metodave dhe proceseve të punës për trajtimin e ankesave apo zhvillimin e veprimtarisë inspektuese dhe hetimore.</i>									
Hartimi i rregullores për trajtimin e ankesave.	DPÇSHJ, në bashkëpunim me inspektorët dhe asistencë të huaj	Janar 2021	5,098		1,020				Hartimi i aktit për miratimin e rregullave procedurale për trajtimin e ankesave

Hartimi i metodologjisë për inspektimin	DPÇSHJ, në bashkëpunim me inspektorët dhe asistencë të huaj	2021			6,118				Hartimi i aktit për miratimin e metodologjisë së inspektimit
<i>Objektivi Specifik 2.3 Përfaqja e metodave/proceseve të punës me standardet ndërkombëtare për hetimin disiplinor dhe inspektimin.</i>									
Analizim të dispozitave ligjore në raport me standardet ndërkombëtare	DPÇSHJ	Në vijimësi	878		878		878		Identifikimi i standardeve
Adresimi i nevojës për ndryshime ligjore	DPÇSHJ	Në vijimësi	2,634		2,634		2,634		Identifikimi i akteve për ndryshim
<i>Objektivi Specifik 2.4 Rritja e numrit të ankesave të trajtuara ne përputhje me afatet ligjore</i>									
Ngritja e grupeve të punës për evidentimin dhe kategorizimin e ankesave të mbartura nga institucionet e tjera, sipas objektit	DPÇSHJ dhe njësia e inspektorëve dhe ndihmës inspektorëve	Dhjetor 2020	579						Miratimi i Urdhrit “Për ngritjen e grupit të punës”
Hartimi i akteve nënligjore për trajtimin e posaçëm të ankesave të mbartura nga institucionet e tjera	DPÇSHJ dhe njësia e inspektorëve dhe ndihmës inspektorëve	Dhjetor 2020	234		66.88				Miratimi i Urdhrit “Për përcaktimin e rregullave për trajtimin e ankesave të mbartura”
Shqyrtimi me prioritet i ankesave sipas gjetjeve të grupeve të punës për evidentimin dhe kategorizimin e ankesave të mbartura nga institucionet e tjera, sipas objektit	Njësia e Inspektorëve dhe Ndihmësinspektorëve	Mars 2021	6,072		51,094.0				Trajtimi çdo muaj i 20% të ankesave.

Përgatitja e raporteve të analizës së grupeve të punës për evidentimin dhe kategorizimin e ankesave të mbartura nga institucionet e tjera, sipas objektit.	DSHJ	2022-2025					48.49		Për këtë masë do të raportohet, për numrin e ankesave të mbartura, sipas ecurisë për kategorizimin e ankesave dhe fillimin e trajtimit sipas radhës së përparësisë të vendosur.”. Numri i ankesave të trajtuara.
--	------	-----------	--	--	--	--	-------	--	--

Objektivi Strategjik 3: Pjesëmarrje aktive në proceset e koordinimit dhe zhvillimit të bashkëpunimit ndërinstytucional.

Objektivi Specifik 3.1: Zhvillimi i një sistemi efektiv, të unifikuar dhe sistematik të raportimit nga të gjitha njësitë organizative të Zyrës së ILD për hartimin, monitorimin dhe raportimin në lidhje me proceset e planifikimit strategjik.

Masat / Aktivitetet e parashikuara	Struktura Përgjegjëse	Afati	Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2020		Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2021		Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2022		Treguesi cilësor/sasior
			PBA	Donatorë	PBA	Donatorë	PBA	Donatorë	
Identifikimi i raporteve ku jep kontribut Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	DPÇSHJ	Në vijimësi	139		48.49				Numri i raportimeve të kryera nga ILD për institucionet e huaja dhe vendase
Koordinimi brenda strukturave të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë sipas afateve të përcaktuara për raportim	DPÇSHJ në bashkëpunim me të gjitha strukturat e tjera të ILD	Në vijimësi	191		16.17				Numri i raportimeve
Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të institucioneve vendase dhe ndërkombëtare sipas raporteve përkatëse	DPÇSHJ	Në vijimësi	14		14		14		Rekomandimet e zbatuara

Objekivi Specifik 3.2: Ndjekja/Realizimi i aktiviteteve që Strategjia Ndërsektorale e Drejtësisë ka parashikuar për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Identifikimi i burimeve financiare për realizimin e aktiviteteve	Drejtoria ekonomike dhe asistencë e huaj + MD	Në vijimësi	207		347		5320		Mënyra e financimit
Zbatimi i aktiviteteve sipas afateve kohore të përcaktuara	DPCSHJ	Në vijimësi							Numri i aktiviteteve
Masa 1.2.9, në funksion të realizimit të Objektivit Specifik 1.2 të SND II: Përgatitja e analizës së zbatimit të reformës në sistemin e drejtësisë bazuar në komponentin e lidhur me ILD-në.	Të gjitha njësitë	2022-2025					584.45		Paraqitja e raporteve statistikore mbi ecurinë e zbatimit të reformës për periudhën e kërkuar të raportimit. Raportet statistikore duhet të evidentojnë: ecurinë e trajtimit të ankesave; ecurinë e rekrutimeve për pozicionin inspektor magjistrat dhe jo magjistrat; ngritje kapacitetesh profesionale të inspektorëve; bashkëpunimi ndërinstitucional.
Masa 1.2.10, në funksion të realizimit të Objektivit Specifik 1.2 të SND II: Përgatitja e përgjigjes mbi analizën e rishikimit të ligjit mbi statusin dhe	Të gjitha njësitë	2022-2025					93.78		Evidentimi i masave në adresim të problematikës dhe në funksion të përmirësimit të kuadrit ligjor, bazuar në raportet statistikore dhe përmirësimit të praktikës së punës.

strukturën qeverisëse të ILD-së (draft-propozimet ligjore).									
Masa 1.2.11, në funksion të realizimit të Objektivit Specifik 1.2 të SND II: Rishikimi dhe konsolidimi i rregullave të brendshme të ILD-së.	DALHA	2022-2025					70.71		Paraqitja e të dhënave në funksion të nevojës për rishikim të akteve nënligjore dhe të studimit të opsioneve e modeleve për të përcaktuar rregulla procedurale të brendshme të rishikuara sa herë që paraqitet nevoja, përmes ndryshimeve që mund të pësojë ligji apo kur lind si nevojë nga zbatimi në praktikë. Numri i akteve të miratuara nga ILD në funksion të rishikimit..
Masa 1.2.12, në funksion të realizimit të Objektivit Specifik 1.2 të SND II: Përgatitja e një plani operacional të ILD-së për trajtimin e ankesave të mbartura.	Njësia e inspektorëve dhe Ndhmësinpektorëve	2022-2025							"Vlerësimi i ecurisë së trajtimit të ankesave në sipas kategorizimit dhe evidentimit dhe shpërndarjes me urdhrat nr 66, datë 28.09.2020, nr. 98, datë 12.11.2020, dhe nr. 41, datë 19.02.2021 duke vendosur afate periodike raportimi të përfundimit të ankesave të mbartura

Masa 1.3.2, në funksion të realizimit të Objektivit Specifik 1.3, të SND II: Përfundimi i procedurave të emërimit të inspektorëve magjistratë dhe jo-magjistratë pranë ILD-së si dhe përfundimi i rekrutimeve të stafit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.	KEV për inspektorët jo magjistratë dhe SP për kërkesat për komandim.	2022 dhe sa herë ka vende vakante për inspektor jomagjistratë”					1650		Raportim mbi ecurinë e procedurave për komandimin e magjistratëve si dhe për rekrutimin e inspektorëve jomagjistratë
Masa që lidhen me objektivin specifik 3.1 dhe 3.2, në zbatim të Qëllimit Politik 3, të SND II	DALHA	2022-2025					34.31		Përgjigje ndaj çdo kërkesë të ardhur për konsultim drejtuar ILD, në cilësinë e institucionit mbështetës.
Masa që lidhen me objektivin specifik 4.1, 4.2, 4.4, në zbatim të Qëllimit Politik 4, të SND II	STI	2022-2025					33.43		Përgjigje dhe kontribut ndaj çdo kërkesë drejtuar ILD-së, në cilësinë e institucionit mbështetës. Numri i kontributeve të përcjella.

Objektivi Strategjik 4: Rritja e transparencës dhe aksesit të publikut në veprimtarinë e Zyrës së Inspektorit të lartë të Drejtësisë.

Objektivi Specifik 4.1: Rritja e aksesit të publikut përmes komunikimit dhe bashkëpunimit me qytetarët.

		Afati	Buxhetimi / Kosto	Buxhetimi / Kosto	Buxhetimi / Kosto	Treguesi cilësor/sasior
--	--	-------	-------------------	-------------------	-------------------	-------------------------

Masat / Aktivitetet e parashikuara	Struktura Përgjegjëse		(në mijë lekë) 2020		(në mijë lekë) 2021		(në mijë lekë) 2022		
			PBA	Donatorë	PBA	Donatorë	PBA	Donatorë	
Hartimi dhe publikimi i modelit të formularit të ankesës dhe udhëzuesit	DPÇSHJ	Shtator 2020	199						Përcaktimi i qartë i elementëve që duhet të përmbajë Formulari i Ankesës
Ofrimi i faciliteteve infrastrukturore për të ngritur një njësi për pritje të publikut	DPÇSHJ	Mars 2021							Anketë vlerësimi
Ofrimi i asistencës së nevojshme lidhur me takimet e mundshme dhe ofrimin e këshillimit për plotë plotësimin e formularit	DPÇSHJ	Në vijimësi	546		546		546		Anketë vlerësimi
Ofrimi i informacioneve (raporte, statistika të gjeneruara nga sistemi) të thjeshtuara në faqen Web për					50.35		50.35		Numri i raporteve të publikuara në faqe.
Publikimi i rezultateve të inspektimit dhe vendimeve të marra në përputhje me parashikimet e ligjit, në një gjuhë të thjeshtuar për publikun					44.34				

Ofrimi i trajnimeve për personat përgjegjës për pritjen me publikun	DPÇSHJ SBNJ	Dhjetor 2020	11						Numri i trajnimeve dhe personave që do të trajnohen
Masa 2.4.9, në funksion të realizimit të objektivit specifik 2.4, të SND II: Ngritja e kapaciteteve të ILD-së për ofrimin e ndihmës/këshillime me publikun për plotësimin e formularit të ankesave.	SBNJ dhe Njësia e Pritjes me Publikun	2022-2025							Evidentimi i nevojave për trajnim për njësinë e re të krijuar si dhe trajnimet e realizuara nga ASPA për këtë njësi. Numri i trajnimeve për njësinë e pritjes me publikun.
<i>Objektivi Specifik 4.2: Zhvillimi i infrastrukturës dhe mjeteve të teknologjisë së informacionit me qëllim bashkëpunimin me publikun si dhe transparencën e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.</i>									
Rikonceptim i “design” të faqes zyrtare për lehtësimin dhe aksesueshmërinë e marrjen e informacionit.	Spektori i TI	Dhjetor 2020	120						Numri i personave që vizitojnë faqen zyrtare të ILD
Publikimi i informacionit për funksionimin e ILD në kuadër të transparencës	Spektori i TI dhe DPÇSHJ	Në vijimësi	1,183		1,133		1,133		Nr. dokumenteve të publikuara
Krijimi i kushteve për plotësimin e ankesave në formë	TI dhe DPÇSHJ	Shtator 2020	1,133		1,133		1,133		Nr. i ankesave online

elektronike (on-line) dhe ngarkimi i dokumentacionit shoqëruar									
<i>Objektivi Specifik 4.3: Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat e sinjalizimit të veprimeve ose praktikave të dyshuara të korrupsionit</i>									
Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për sinjalizimin e veprimeve ose praktikave korruptive të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	Sekretari i Përgjithshëm	Tetor 2021							Fushata ndërgjegjësimi